LIGJ
Nr.8404, datë 15.9.1998

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7978, DATË 26.7.1995 "PËR FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991"Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7978, datë 26.7.1995 "Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në nenin 4, në vazhdim të fjalisë së dytë shtohen fjalët:

"me përjashtim të njësive komando dhe të Policisë Ushtarake, të cilat, me kërkesë të ministrit të Rendit Publik dhe me miratim të ministrit të Mbrojtjes, mund të përdoren vetëm në mbrojtje të institucioneve shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë dhe veprojnë në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore që rregullojnë funksionimin e forcave të Policisë së Rendit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi me dekretimin nga Presidenti i Republikës.

Shpallur me dekretin nr.2218, datë 15.9.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani